



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

RAPORTI VJETOR 2014

Përmbajtja

I. MISIONI DHE OBJEKTIVAT KRYESORË PËR VITIN 2014.....	3
II. E DREJTA PËR INFORMIM.....	5
II.1 Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”	5
II.2 Monitorimi i Ligjit për të Drejtën e Informimit	5
II.3 Aktivitete mbi të drejtën e informimit.....	6
II.4 Problematikat e implementimit të ligjit “Për të drejtën e informimit”	6
III. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE.....	8
III.1 Identifikimi i subjekteve kontrolluese e përpunuese.....	8
III.1.1 Njoftimi dhe Regjistrimi i Subjekteve Kontrollues.....	8
III.1.2 Administrimi i Kanalit të Komunikimit	9
III.2.1 Hetime administrative në terren dhe online	10
III.2.2 Trajtimi i ankesave	12
III.2.3 Sanksione administrative gjatë vitit 2014	12
III.2.4 Ndjekja e proceseve gjyqësore dhe ekzekutimi i vendimeve nga përmbarimi	13
III.3 Aktivitete mbi privatësinë	14
IV. AKTIVITETI LIGJOR	16
IV.1 Miratimi i akteve nënligjore.....	16
IV.2 Udhëzues/udhërrëfyes të miratuar	17
IV.3 Dhënie mendimi për projekt/akte ligjore dhe nënligjore	18
IV.4 Përbushja e detyrimeve ligjore.....	19
IV.5 Raportime.....	20
V. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL	21
V.1 Marrëveshje Bashkëpunimi	21
V.2 Marrëdhënie Ndërkombëtare.....	22
VI. BURIMET NJERËZORE DHE MENAXHIMI FINANCIAR	24
VI.1 Struktura Organizative	24
VI.2 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore.....	25
VI.2 Menaxhimi Financiar	25
VII. PRIORITETET PËR VITIN 2015	27
VIII. STATISTIKA DHE GRAFIKË	28

I . MISIONI DHE OBJEKTIVAT KRYESORË PËR VITIN 2014

Garantimi i dy të drejtave kushtetuese të njeriut, e drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale, përbëjnë misionin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP). Gjatë vitit 2014, veprimtaria institucionale është përqëndruar fillimisht në mbrojtjen e të dhënave personale dhe më pas edhe në shtyllën tjetër të rëndësishme, të drejtën për informim. Progresi i nisur dhe intensifikuar në muajt e fundit është paraprirë nga ligjet bazë që rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni, rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të paraqitura në Rezolutën “*Për vlerësimin e punës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2013*” si dhe *Progres Raporti i BE-së*.

Në aktivitetin e punës, Zyra e Komisionerit ka pasur prioritet të saj parandalimin dhe shmangien e rasteve të përpunimit të kundërligjshëm të të dhënave personale. Forcimi i zbatimit të ligjit është konsideruar i lidhur ngushtë me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit nënligjor si dhe me rolin tonë aktiv për t’i ofruar asistencë ligjore subjekteve të ndryshëm publik dhe privat. Është konstatuar një rritje e numrit të projekt/ligjeve dhe projekt/akteve nënligjore të ardhura për mendim. Ky fakt është tregues i krijimit të kulturës mbi ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rritjes së besimit për rolin e Zyrës së Komisionerit.

Ky raportim identifikon ndërmarrje të iniciativave të reja lidhur me përmirësimin e teknikave të hetimit administrativ të pasqyruara kryesisht në muajt e fundit të vitit kalendarik 2014, si pasojë e të cilave është rritur ndjeshëm numri i inspektimeve. Tërësia e procesit të hetimit administrativ është rrjedhim i ankesave të subjekteve, por edhe hetime administrative të ndërmarra kryesisht, nga Zyra e Komisionerit.

Zbatimi i buxhetit është një hallkë tjetër e rëndësishme institucionale. Gjatë këtij viti janë mirë administruar shpenzimet buxhetore të miratuara, në mbështetje të ushtrimit të kompetencave e funksioneve të Zyrës, në drejtim të monitorimit të dy ligjeve, kryerjes së hetimeve administrative, ndërgjegjësimit, përmirësimit të imazhit dhe forcimit të besimit të publikut ndaj Zyrës.

Miratimi i ligjit Nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” përbën një moment tjetër për të vlerësuar në veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për vitin 2014. Në muajin nëntor, Zyrës së Komisionerit ju atribuan kompetencat e parashikuara në këtë ligj duke i dhënë një fizionomi tjetër institucionit. Natyrshëm u synua identifikimi i objektivëve të parë dhe nevoja për t’u angazhuar në realizimin e tyre. Kryesisht u synua në monitorimin e zbatimit të ligjit, ndërgjegjësim të autoriteteve publike dhe shoqërisë në tërësi, trajtim të ankesave të individëve në afat, përgatitje të programit model të transparencës, etj.

Risi tjetër për vitin 2014 ishte edhe miratimi me datë 30 tetor 2014 nga Kuvendi i Shqipërisë i ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.” Ligji ka për objekt rregullimin e

marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent, gjithëpërfshirës, lidhur me procedurën e vendimmarrjes së projekt akteve me karakter normativ, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale si dhe politikave me interes të lartë publik. Ligji ka parashikuar ankimin pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në rast se palët e interesuara vlerësojnë se organi publik ka cënuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik. Ligji hyn në fuqi në maj të vitit 2015.

KDIMDP ka shënuar arritje edhe në planin e marrëdhënieve ndërinstitucionale dhe ato ndërkombëtare. Zyra e Komisionerit është përfaqësuar në disa takime të rëndësishme ndërkombëtare.



**NË NJË SHOQËRI TË LIRË DHE TË HAPUR
INSTITUCIONET PUBLIKE
DUHET TË JENË TRANSPARENTE
LIDHUR ME INFORMACIONIN PUBLIK
PËR SHTETASIT E SAJ**

II. E DREJTA PËR INFORMIM

II.1 Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, u miratua në Kuvend në 18 shtator 2014 dhe u botua në Fletoren Zyrtare Nr.160, datë 17 tetor 2014. Ky ligj ka për qëllim të garantojë rregulla konkrete për mbrojtjen dhe shndërrimin e të drejtës së informimit në një të drejtë reale dhe lehtësisht të zbatueshme në praktikë.

Reformimi i këtij ligji e sjell atë në një nivel me legjislacionin e përparuar të rajonit dhe më tej. E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale janë dy fusha që duhen trajtuar së bashku, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të vendoset një balancë midis tyre dhe privatësia e individit mund të mbrohet edhe kur jepet informacion mbi dokumente zyrtare. Në këto kushte u morën si shembull eksperiencat dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe u vendos që në kompetencë të autoritetit të mbrojtjes së të dhënave personale të shtohet një prej shtyllave të tjera të rëndësishme edhe e drejta e informimit.

Risite që solli ligji “Për të drejtën e informimit” fokusohen në:

- Përcaktimin e dy kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe me kërkesë;
- Mbrojtjen e së drejtës për informim që ka çdo individ, pa qenë nevoja të sqarojë motivet;
- Rregullimin e njohjes me informacionin/dokumentin zyrtar publik;
- Rregullimin e përgatitjes dhe miratimit të programeve të transparencës;
- Krijimin e një figure të re, siç është koordinatori për të drejtën e informimit, dhe parashikimin e kompetencave të tij;
- Rregullimin e kompetencave dhe procedurave për shqyrtimin e ankesave;
- Parashikimin e kufizimit të së drejtës për informim;
- Parashikimin e shkeljeve dhe sanksioneve administrative.

Kompetencat dhe procedurat për shqyrtimin e ankesave i janë atribuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

II.2 Monitorimi i Ligjit për të Drejtën e Informimit

Intervali kohor i marrjes në kompetencë të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2014 është i shkurtër, pasi i përket dy muajve të fundit të vitit, por çështjet që u trajtuan ishin të shumta, gjë që imponoi një angazhim të menjëhershëm të burimeve ekzistuese.

Duke filluar nga nëntori deri në fund të muajit dhjetor, pranë Zyrës së Komisionerit janë depozituar **26 ankesa** nga persona fizikë dhe persona juridikë lidhur me mosrespektimin dhe

garantimin e së drejtës për informim. Nga këto ankesa vetëm 4 janë deleguar nga institucioni i Avokatit të Popullit. Ndërkohë, nga numri total i ankesave, për 5 raste është kryer inspektim, për 3 raste janë zhvilluar seanca dëgjimore, ndërsa **janë dhënë 2 vendime** për pranim të objektit të ankesës dhe urdhërim të autoriteteve për të dhënë informacionin e kërkuar.

Nga çështjet e shqyrtuara, Zyra e Komisionerit konstaton se ligji për të drejtën e informimit nuk është zbatuar në nivelin e kërkuar nga administrata publike qendrore dhe vendore, duke shmangur kështu detyrimet e tyre për dhënien e informacionit të kërkuar, pas kërkesës me shkrim të individëve.

Autoritetet publike nuk kanë caktuar ende koordinatorin, detyrim i parashikuar në ligj. Komisioneri, në çdo rast të komunikimit shkresor por dhe në aktivitete të zhvilluara për këtë qëllim ka kërkuar përmbushjen e këtij detyrimi ligjor. Vetëm 4 (katër) autoritete publike, kanë njoftuar për caktimin e koordinatorit. Ndërkohë, nuk është proceduar me sanksione administrative për t'u dhënë mundësinë Autoriteteve Publike për njohjen e procedurave të ligjit dhe përmbushjen e detyrimit brenda afatit kohor prej 6 muaj për miratimin dhe vënien në zbatim të programit të transparencës.

Nën angazhimin tonë maksimal dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore u hartua e miratua, me urdhërin e Komisionerit nr.14, datë 22.01.2015 “Programi Model i Transparencës për autoritetet publike”, dokument tashmë i publikuar në faqen zyrtare të KDIMDP-së www.idp.al dhe në *Fletoren Zyrtare Nr 6, datë 28 janar 2015*.

II.3 Aktivitete mbi të drejtën e informimit

Për zhvillimin dinamik të këtij kuadri ligjor, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë OSFA, me datë 18 dhjetor 2014 organizuan Konferencën “E Drejta Për Informim & Autoritetet Publike”. Qëllimi i Konferencës ishte prezantimi i risive të ligjit të sapo miratuar Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” përpara nëpunësve më të lartë të administratës publike. Gjatë konferencës, Zyra e Komisionerit prezantoi përpara aktorëve më të rëndësishëm të administratës publike qendrore e lokale si dhe shoqërisë civile, projekt aktet e hartuara në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit me qëllim konsultimin publik të tyre përpara miratimit përfundimtar duke lënë një afat një mujor për dhënie mendimi.

II.4 Problematikat e implementimit të ligjit “Për të drejtën e informimit”

Gjatë shqyrtimit të çështjeve të para për të drejtën e informimit, kemi evidentuar probleme që lidhen me përmbajtjen e dispozitave të ligjit, si dhe me zbatimin konkret të tyre. Disa nga këto problematika janë:

- Trajtimi i çështjes bëhet vetëm për të konstatuar ndjekjen e procedurave nga autoritetet publike për trajtimin e kërkesave, ndërsa duhet përcaktuar edhe shqyrtimi i ankesave në themel, nga Komisioneri.
- Kërkohej të përcaktohet kategoria e “Autoriteteve publike”, pasi disa prej tyre megjithëse ushtrojnë funksione publike nuk përmbushin kritere të përcaktuara në përmbajtje të këtij përkufizimi.
- I njëjti përcaktim duhet bërë edhe për kategorinë e sistemit gjyqësor pasi ankesat adresohen edhe për pajisje me vendime gjyqësore apo dosje gjyqësore të palëve ndërgjyqëse. Ndërsa do të duhet të jepet një përgjigje nga autoriteti/sistemi gjyqësor, konkuron vijueshmëria e procesit gjyqësor në përputhje me legjislacionin civil, penal dhe atë administrativ.
- Duhet qartësuar termi “informacion publik” (sa i përket informacionit të krijuar).
- Mosmarrja e masave nga ana e Autoriteteve Publike për zbatimin e nenit 10 të ligjit, për caktimin e një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit të cilit ligji i ka parashikuar disa kompetenca, përbën një pengesë thelbësore për zbatimin e këtij ligji në kohë e me cilësinë e duhur.
- Analiza e afatit 15 ditë pune për shqyrtimin e ankesës në raste të veçanta, duket e pamjaftueshme, ku për disa veprime siç është rasti i kërimit të parashtrimeve apo zhvillimit të seancave dëgjimore, lind nevoja për t’iu referuar afateve të përcaktuara në K.Pr.Administrative apo edhe ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet Administrative”.
- Hyrja në fuqi e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” nuk i parapriu krijimit të një strukture të posaçme e cila do të implementonte me efikasitet këtë ligj të ri. Në kushte të tilla, Zyra e Komisionerit ka hasur vështirësi në rekrutimin e nëpunësve për shkak të zbatimit të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe për shkak të natyrës specifike të të drejtës për informim. Që në fillimet e zbatimit të ligjit, Zyra është përballur me fluks ankesash, komunikime dhe asistencë të ndryshme, përballë një mungese të plotë të stafit.
- Ambientet në të cilat ushtron veprimtarinë e punës Zyra e Komisionerit, aktualisht janë të pamjaftueshme për të siguruar sistemimin me vend pune për çdo punonjës, si dhe identifikojnë mungesën e aksesit për publikun, si dhe kryerjen e veprimtarive të tjera publike e private që zhvillohen brenda të njëjtës godinë dhe që nuk kanë lidhje me natyrën dhe aktivitetin e kësaj zyre. I njëjti vlerësim vjen edhe nga Misioni i Ekspertëve në rekomandimet e dhëna.

III. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

III.1 Identifikimi i subjekteve kontrolluese e përpunuese

Edhe për këtë vit prioritet i punës së Komisionerit ka qenë angazhimi në drejtim të një identifikimi më të plotë të subjekteve kontrolluese e përpunuese, sensibilizimi i tyre, njohja me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar si dhe zbatimi i detyrimit ligjor për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit për gjendjen e përpunimit të të dhënave personale.

Procesi i sensibilizimit të subjekteve kontrolluese ka vazhduar si nëpërmjet dërgimit të shkresave informuese, me anë të të cilave u kërkojmë këtyre subjekteve që të zbatojnë detyrim ligjor për të njoftuar, po ashtu edhe me seminare të organizuara për këtë qëllim. Janë asistuar subjektet kontrolluese për mënyrën e plotësimit të Formularit të Njoftimit dhe për çdo paqartësi tjetër lidhur me të.

Gjatë vitit 2014 janë filtruar dhe evidentuar nga lista e subjekteve të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit **802** subjekte, të cilëve u është dërguar shkresa sensibilizuese si dhe kemi dërguar rreth **600** e-mail sensibilizues duke përdorur adresat elektronike të subjekteve kontrolluese të cilat janë të regjistruara në Shërbimin Kombëtar të Punës.

Në sajë të politikës dhe strategjisë për të ndihmuar e asistuar subjektet kontrolluese që njoftojnë, është kryer komunikim telefonik me rreth **1000** telefonata, ku kontrollues të ndryshëm kanë telefonuar pranë zyrave tona për sqarime ose asistencë. Janë pritur dhe asistuar pranë ambjenteve të zyrës rreth **300** subjekte kontrollues. Gjithashtu, janë kryer edhe aktivitete sensibilizuese në terren me kontrollues të ndryshëm të cilët janë njohur me ligjin, detyrimin për njoftim dhe i është dhënë asistencë gjatë plotësimit të formularit të njoftimit.

III.1.1 Njoftimi dhe Regjistrimi i Subjekteve Kontrollues

Si rezultat i strategjisë sensibilizuese, por edhe detyruese ligjore, gjatë kësaj periudhe pranë Zyrës të Komisionerit kanë njoftuar **728** subjekte kontrolluese. Numri i përgjithshëm i njoftimeve të përpunimeve nga kontrolluesit në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në fund të vitit 2014 ka mbërritur në **4707**. Në krahasim me vitin e mëparshëm këtë vit janë kryer **146** deklarime me shumë.

Kemi vijuar me regjistrimin dhe publikimin online në Regjistrin e Hapur për Publikun të njoftimeve që rezultojnë se kryejnë përpunimin e të dhënave personale konform kërkesave të neneve 5 dhe 6 të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i

ndryshuar. Numri i subjekteve kontrolluese të regjistruara për këtë periudhë është **802**, duke e çuar numrin e subjekteve të regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve Kontrolluese në **4665**. Në krahasim me vitin e mëparshëm këtë vit janë kryer **135** regjistrime më shumë.

Bazuar në nenin 23 të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, kemi trajtuar nëpërmjet kërkesës për informacion plotësues **112** deklarime që kanë rezultuar të paplota, të paqarta, si dhe për të verifikuar më tej ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave nga kontrolluesi deklarues, si dhe në kuadrin e paraqitjes së kërkesave për autorizimin e Komisionerit për përpunimin e të dhënave sensitive dhe transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.

Gjithashtu, nëpërmjet shqyrtimit të formularëve të njoftimit janë iniciuar dy praktika, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave, të cilat kanë çuar në plotësimin e informacionit nga ana e kontrolluesve si dhe inicimin nga ana e tyre të procedurave për kërkesën për marrjen e Autorizimit të Komisionerit për transferim ndërkombëtar të të dhënave në vende pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave. Saktësimet, plotësimet apo dhënia e autorizimeve është pasqyruar në Regjistrin Elektronik të Subjekteve Kontrollues.

Me gjithë vështirësitë në gjetjen e adresave të sakta, gjatë këtij viti është punuar për të bërë verifikimin dhe sensibilizimin e plotë për të gjitha subjektet kontrolluese me status ligjor “Zyra Përfaqësie”, të cilët kanë detyrimin ligjor për njoftim.

III.1.2 Administrimi i Kanalit të Komunikimit

Kemi mbajtur kontakte të vazhdueshme me personat e kontaktit të ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave personale pranë Kontrolluesve, kryesisht atyre publik, me qëllim informimin sa më të shpejtë lidhur me aktet që nxjerr Komisioneri dhe për çdo komunikim apo asistencë të nevojshme. Roli kryesor në këtë periudhë raportimi, ka synuar kryesisht ndërgjegjësimin e kësaj kategorie me detyrimet që duhen përmbushur nga çdo kontrollues në zbatim të Udhëzimit Nr.21 të Komisionerit, “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*”.

Të tjera

Një prej detyrave të përcaktuara në rezolutën e Kuvendit mbi vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit për vitin 2013, ishte identifikimi sa më i plotë i subjekteve kontrolluese e përpunuese dhe regjistrimi i tyre në regjistrin e subjekteve kontrolluese. Në muajin nëntor në përgjigje të kërkesës sonë, QKR vendosi në dispozicion listën e përditësuar të subjekteve kontrolluese të cilët ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Ky informacion ishte i nevojshëm për të kryer një filtrim të detajuar të subjekteve që kanë detyrimin për të njoftuar, të atyre që e kanë zbatuar këtë detyrim si dhe ata të cilët nuk ushtrojnë më aktivitetin e tyre. Me marrjen e këtij informacioni ka nisur puna për identifikimin e kontrolluesve dhe kategorizimin e tyre sipas fushës së veprimtarisë, me qëllim sensibilizimin në lidhje me detyrimin ligjor për të

njoftuar dhe bërë regjistrimin në regjistrin e subjekteve kontrolluese. Gjithashtu, kemi kërkuar bashkëpunimin e Ministrisë së Drejtësisë, pasi ky kontrollues kujdeset për funksionimin dhe organizimin e profesioneve të lira juridiko-profesionale si të fushës së avokatisë, noterisë, ndërmjetësimit, përmbarimit gjyqësor privat, ndihmës juridike për informimin e këtyre kontrolluesve në lidhje me përmbushjen e detyrimit ligjor për të njoftuar.

III.2.1 Hetime administrative në terren dhe online

Kontrolle administrative

Përgjatë vitit 2014 nga Zyra e Komisionerit janë kryer kontrolle administrative, me objekt të përgjithshëm, “Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri.

Realizimi i këtyre kontrolleve është angazhim i vazhdueshëm i zyrës së Komisionerit dhe realizohet me qëllim ushtrimin e detyrave të mbikëqyrjes dhe monitorimin e respektimit nga ana e kontrolluesve publikë dhe privatë të rregullave në lidhje me mbrojtjen e privatësisë dhe përpunimin e drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale.

Në këtë kuadër, janë realizuar **67** kontrolle administrative me objekt të përgjithshëm.

Disa fusha ku është ushtruar kontroll sektorial nga zyra e Komisionerit

Gjatë muajve tetor- nëntor të vitit 2014 pranë të gjitha shoqërive të sigurimit është ushtruar kontroll administrativ. Shoqëritë e sigurimit gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, mbledhin, përpunojnë dhe ruajnë një numër të konsiderueshëm të dhënash personale, si dhe të dhëna sensitive për subjekte të ndryshëm të të dhënave, veçanërisht për kategorinë “klient” duke u rritur në këtë mënyrë shkalla e riskut në drejtim të mbrojtjes së të dhënave personale. Qëllimi i këtyre kontrolleve ka qenë monitorimi dhe mbikëqyrja për të verifikuar nëse tregu i sigurimeve vepron në një mjedis të sigurt, në kuadër të garantimit të mbrojtjes së të drejtave të subjekteve të të dhënave. Nga kontrollet e ushtruara u verifikuan shkelje të dispozitave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, kryesisht në drejtim të detyrimit për informim të subjekteve të të dhënave dhe marrëdhënieve me të tretët në drejtim të privatësisë.

Pranë disa Ministrive, të cilat në veprimtarinë e tyre, sipas fushave specifike si ofrues të shërbimeve publike, konsiderohen kontrollues të të dhënave personale që përpunojnë një kategori të konsiderueshme të dhënash personale, së bashku me institucionet e varësisë është ushtruar kontroll me objekt të përgjithshëm. Nga kontrollet e ushtruara vlen të përmendet kontrolli i ushtruar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) tek e cila u realizua edhe verifikimi i zbatimit të urdhërit të Komisionerit, në lidhje me “Pyetësorin e gjendjes së shëndetit të nxënësit” dhe “Kartelën individuale të nxënësit”. Këta pyetësorë ishin shpërndarë nga MAS për t’u plotësuar pranë Drejtorive Rajonale Arsimore dhe Qendrave në Rrethe në kuadër të zbatimit të urdhërit “Për plotësimin e materialeve didaktike të lëndës së edukimit fiziko-sportiv

në sistemin arsimor para-universitar” të kësaj Ministrie. Nga përmbajtja e tyre, nëpërmjet të cilave mblidheshin të dhëna personale dhe sensitive të personave (nxënësve) të mitur, të cilët gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga ligji, u konstatuan shkelje të dispozitave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Për këtë qëllim zyra e Komisionerit urdhëroi tërheqjen e këtyre pyetësorëve dhe pezullimin e procesit të përpunimit dhe mbledhjes së të dhënave deri në reflektimin e parimeve të ligjit. Kontrolluesi reagoi duke realizuar tërheqjen e pyetësorëve dhe aktualisht procesi është në fazë monitorimi për sa i përket ndryshimeve në përmbajtjen e tyre.

Inspektive administrative

KDIMDP ka ushtruar inspektive në terren dhe inspektive online. Inspektimet online janë fokusuar në përpunimin e të dhënave personale në faqen në internet të kontrolluesve, politikat e privatësisë, informimin e subjekteve të të dhënave personale, mënyrat e marrjes së pëlqimit të subjekteve të të dhënave personale, publikimin e të dhënave personale, ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave që mblidhen nga faqja në internet e kontrolluesit, etj.

Për shkak të zhvillimeve teknologjike, një pjesë e madhe e shërbimeve nga kontrolluesit publik dhe privat realizohen online. Zhvillimi i inspektiveve online është konsideruar si një mënyrë për rritjen e ndërgjegjësimit të kontrolluesve mbi rëndësinë e respektimit të rregullave në lidhje me privatësinë, detyrimin e tyre për të informuar subjektet e të dhënave personale në lidhje me të drejtat e tyre në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë kuadër përveç të tjerash është e nevojshme që, kontrolluesi në faqen e tij në internet të publikojë, “*politikat e privatësisë*” (paketë rregullash) me qëllim, informimin e subjekteve të të dhënave dhe personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë dhe ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e tyre dhe detyrimet si kontrollues. Në të njëjtën kohë, është konsideruar si një mundësi për rritjen e ndërgjegjësimit, sensibilizimin e subjekteve të të dhënave dhe personave që vizitojnë faqen, mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

Nga zyra e Komisionerit janë zhvilluar **53** inspektive online, në faqet në internet të kontrolluesve dhe për të gjithë këta kontrollues është dërguar fillimisht rekomandim. Kjo është bërë me qëllim krijimin e hapësirës ligjore që vetë kontrolluesit të rikuperojnë shkeljet dhe të garantojnë që veprimtaria e tyre të realizohet në përputhje me parimet e ligjit dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij. Për këto rekomandime është bërë verifikimi online i zbatimit të tyre nga ku ka rezultuar se **15** kontrollues nuk kishin reflektuar rekomandimin dhe për **3** prej tyre është proceduar me sanksion administrativ gjorbë.

Gjithashtu, janë realizuar inspektive administrative në terren mbi bazë ankesash, verifikimi të përmbushjes së rekomandimeve dhe urdhrave të Komisionerit si dhe verifikim përmbushjeje të

detyrimeve të përcaktuara në ligj. Në total numri i inspektimeve në terren ka qenë **37** prej të cilave **27** kanë qenë me objekt verifikim i zbatimit të rekomandimeve/ urdhrave të Komisionerit. Rezultojnë në total **90** inspektime administrative dhe **80** inspektime administrative mbi verifikimin e përmbushjes së rekomandimeve/urdhërave të Komisionerit.

III.2.2 Trajtimi i ankesave

Gjatë vitit 2014 pranë KDIMDP-së janë paraqitur 73 ankesa dhe kërkesa për informacion për mbrojtjen e të dhënave personale në kontrollues të ndryshëm. Disa prej ankesave nuk kanë rezultuar në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale ndërsa për **36** ankesa janë marrë të gjitha masat për orientimin e subjekteve në ushtrimin e të drejtave të përcaktuara me ligj dhe në çdo rast sipas specifikave konkrete janë nxjerrë urdhërat e inspektimit dhe janë kryer verifikimet e duhura në terren.

Në përputhje me objektin e ankesave, përmbajtjen e tyre si dhe nga shqyrtimi i mëtejshëm ka rezultuar që shqetësimet e subjekteve të të dhënave i kanë takuar kryesisht:

- ✓ Publikimit të të dhënave personale në media dhe në faqet zyrtare në internet të kontrolluesve;
- ✓ Marrjes së pëlqimit për realizmin e marketing-ut direkt;
- ✓ Ushtrimit të të drejtës për akses dhe korrigjim/ fshirje të të dhënave personale;
- ✓ Publikimit të të dhënave personale në vendimet gjyqësore, etj.

Ankesat pranë zyrës së Komisionerit, përveçse zyrtarisht, mund të dërgohen edhe nëpërmjet postës elektronike së institucionit www.info@idp.al ose numrit jeshil. Kjo ka bërë të mundur një komunikim të shpejtë dhe më të drejtëpërdrejtë. Në çdo rast, kur është realizuar trajtimi i tyre i mëtejshëm e-maillet janë administruar në mënyrë zyrtare.

Në procesin e trajtimit të ankesave është treguar kujdes në shqyrtimin me efektivitet duke dhënë asistencën e duhur për subjektet e të dhënave, duke orientuar mbi mënyrat dhe veprimet që duhet të ndiqen me qëllim ushtrimin e të drejtave të njohura me ligj. Gjithashtu, është synuar që hetimi të jetë i plotë dhe efektiv, të konsistojë në vendimmarrje proporcionale, të bazuar në reagimin e kontrolluesve dhe interesin publik.

III.2.3 Sanksione administrative gjatë vitit 2014

Gjatë këtij viti Zyra e Komisionerit është shprehur me **11** vendime për kontrollues të ndryshëm që korrespondojnë me **19** sanksione administrative me **gjobë**. Në zbatim të kompetencave ligjore pas ushtrimit të kontroleve dhe inspektimeve administrative janë vendosur gjoba për kontrollues të cilët janë gjetur në shkelje të ligjit. Sanksioni administrativ me gjobë për këta kontrollues ka ardhur si rezultat i seriozitetit të shkeljeve të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit/inspektimit,

faktit që këta kontrollues në disa raste kanë qenë përsëritës në moszbatimin e detyrimeve që ju ngarkon ligji dhe një pjesë tjetër si rezultat i ushtrimit të inspektimeve me qëllim verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të zyrës së Komisionerit, nga ku është konstatuar mospërbushje e detyrimeve.

Shkeljet për të cilat janë vendosur sanksione i referohen kryesisht mosrespektimit nga ana e kontrolluesve, të detyrimit për informim të subjektit të të dhënave personale, të detyrimit në lidhje me marrjen e masave për sigurinë e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, detyrimit për të parashikuar, klauzola, dispozita mbi parimet e mbrojtjes së të dhënave personale në marrëveshjet kontraktuale me të tretë dhe detyrimit që ka të bëjë me plotësimin dhe përditësimin e “formularit të njoftimit” pranë zyrës së Komisionerit. Vendosja e sanksioneve administrative është realizuar nga Zyra e Komisionerit në mbështetje të ligjit si edhe në respektim të parimeve të ligjshmërisë, transparencës në vendimmarrje dhe të drejtës së palëve për t’u dëgjuar. Për të gjitha rastet përpara marrjes së vendimit përfundimtar janë zhvilluar seanca dëgjimore me subjektet kontrollues.

III.2.4 Ndjekja e proceseve gjyqësore dhe ekzekutimi i vendimeve nga përmbarimi

Proceset gjyqësore

Është vijuar me ndjekjen e proceseve gjyqësore për 3 raste të cilat janë duke u trajtuar në vijim të vitit 2013. Prej tyre, 2 procese me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” janë duke u shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, ndërsa për *procesin tjetër gjyqësor* është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Për rastet e evidentuara janë marrë masat e nevojshme për përfaqësimin në gjykatë brenda afateve procedurale ligjore.

Gjithashtu, janë ndjekur 3 procese gjyqësore me kërkesë “Lëshim urdhëri ekzekutimi” për vendimet me sanksion administrativ gjobë të cilat nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga subjektet kontrollues. Në tërësi rezultojnë 6 procese gjyqësore të ndjekura gjatë vitit 2014.

Ekzekutimi i vendimeve

Është vijuar me vënien në ekzekutim *të vendimeve të gjobave të zyrës së Komisionerit*. Gjatë këtij viti janë marrë masa që të bëhet një rievendim i të gjithë situatës në lidhje me ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve të gjobës të vendosura përgjatë gjithë periudhës së veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit.

Për këtë qëllim është bërë një rievendim i të gjithë ekzekutimeve, është kontaktuar me përfaqësuesit e zyrave të përmbarimit me të cilat Zyra e Komisionerit ka lidhur kontrata shërbimi për ekzekutimin e vendimeve të gjobave dhe janë organizuar takime në ambientet e Komisionerit me këta përfaqësues. Është kontaktuar me subjektet kontrollues të cilët nuk kanë përmbushur

vullnetarisht detyrimin për pagimin e shumë sipas vendimit të Komisionerit për dënimin me gjobë. Për subjektet që nuk kanë shprehur vullnet për ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit, janë përgatitur kërkesat, gjithsej 3 të tilla, për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit në gjykatë (*vendime të dhëna përpara vitit 2014*), dhe janë ndjekur proceset gjyqësore përkatëse.

Në mënyrë statistikore situata e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve të gjobave *përpara vitit 2014* rezulton: Zyra e Komisionerit ka vendosur gjithsej 57 sanksione administrative gjobë, nga të cilat 3 vendime janë ankimuar dhe janë ende duke u ndjekur proceset gjyqësore, 2 vendime janë revokuar.

Sa më sipër, vendime që janë vënë në ekzekutim të detyrueshëm në zyrat përmbartimore janë 52 që i korrespondojnë sanksioneve administrative me gjobë, nga të cilat deri në vitin 2013 janë ekzekutuar nga përmbartimi 30 prej tyre.

Në vitin 2014, pasi zyra e Komisionerit riktheu vëmendjen në ekzekutimin e vendimeve të prapambetura, u vu në lëvizje ekzekutimi i 22 vendimeve të cilat kishin mbetur pa ekzekutuar. U arrit të ekzekutohen 16 vendime dhe janë në proces ekzekutimi të detyrueshëm 6 vendime të tjera. Për sa i përket vendimeve me sanksion administrativ gjobë të vendosura gjatë vitit 2014, janë 11 vendime të cilat korrespondojnë me 19 sanksione administrative gjobë.

Për vitin 2014, zyra e Komisionerit, pas vendosjes së sanksioneve administrative ka kontaktuar me kontrolluesit për ekzekutim në mënyrë vullnetare të gjobës dhe rezulton se 4 kontrollues kanë ekzekutuar në mënyrë vullnetare që korrespondon me 8 sanksione administrative. Ndërkohë, 2 kontrollues kanë ankimuar vendimin në gjykatë dhe 5 kontrollues nuk i janë përgjigjur ekzekutimit vullnetar të vendimeve dhe nga Zyra e Komisionerit, për të cilat do të vazhdohet të merren masa për veprimet e mëtejshme pas kalimit të afatit ligjor për ankimim dhe kthimin në titull ekzekutiv, për vënien në ekzekutim të detyrueshëm nëpërmjet zyrave përmbartimore.

Shumat e arkëtuara (në vlerë monetare) në buxhetin e shtetit nga vendimet e gjobave:

- ✓ Vlera e arkëtuar në buxhetin e shtetit nga sanksionet administrative me gjobë, **përpara vitit 2014**, rezulton **103.400** lekë.
- ✓ Vlera e arkëtuar në buxhetin e shtetit nga sanksionet administrative me gjobë, **për vitin 2014**, rezulton **677.902** lekë.

III.3 Aktivitete mbi privatësinë

28 Janari, Dita Evropiane e Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Me rastin e Ditës Evropiane të Privatësisë, Zyra e Komisionerit organizoi konferencën me temë, “Mbrojtja e të Dhënave Personale, e drejtë themelore e njeriut”.

Paralelisht me konferencën në ambientet e autoritetit u zhvillua “Dita e Hapur”. Përfaqësues të Zyrës ishin në shërbim të individëve për të diskutuar e ndarë me ta çështje të ndryshme lidhur me privatësinë.

Konkursi letrar

Në datë 31 janar, në ambientet e shkollës Dora d’Istria u zhvillua ndarja e çmimeve për krijimin letrar më të mirë të shkollës 9 vjeçare, për konkursin me temë “*Të mbrojmë privatësinë*”. Nxënës të shumtë sollën krijimet e tyre letrare në gjuhën shqipe, angleze dhe atë frënge dhe një komision i përbashkët midis mësuesve dhe përfaqësuesve të zyrës së Komisionerit ndanë çertifikata për krijimet më të mira.

Leksion i hapur me studentët e nivelit Master të Universitetit New York Tirana

Në muajin shkurt përfaqësues të zyrës së Komisionerit, morën pjesë në një orë të hapur me studentët e Masterit të Fakultetit Juridik në Universitetin e New York Tirana për të diskutuar mbi çështje të ndjeshme lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

Seminar trajnues për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

Në datë 12 mars përfaqësues të zyrës së Komisionerit zhvilluan një seminar trajnues për punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për një përmbledhje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale por kryesisht mbi amendimet e tij, risitë që sollën ato por edhe për tema të tjera të rëndësishme.

Seminar ndërgjegjësues me përfaqësues të administratës vendore në Qytetin e Korçës dhe Pogradecit

Në muajin maj, zyra e Komisionerit organizoi dy seminare me përfaqësues të administratës publike në qytetin e Korçës dhe Pogradecit me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve publikë me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe zbatimin e legjislacionit përkatës në Shqipëri.

Aktivitet me nxënësit e shkollës Muharrem Çollaku në Pogradec

Përfaqësues të zyrës së Komisionerit në takimin me nxënësit e shkollës së mesme “Muharrem Çollaku” në Pogradec dhanë këshilla për sa i përket mbrojtjes nga sulmet kompjuterike të cilat mund të çenojnë privatësinë individuale, nëpërmjet fjalëkalimeve të sigurta, përdorimin e antivirusëve, spyware etj.

Trajnim i personave të ngarkuar

KDIMDP në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) ka vazhduar trajnimin e thelluar me personat e ngarkuar të kontrolluesve publikë nëpërmjet moduleve të administruara prej tyre. Aktualisht identifikohen rreth 65 persona të çertifikuar në këtë fushë.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pjesë e Panairit të Librit të 17-të “Tirana 2014”

KDIMDP në datat 12-16 nëntor, mori pjesë në Panairin e 17-të Librit “Tirana 2014”. Në këtë event u vunë në dispozicion të publikut materiale ndërgjegjëse, si broshura apo fletëpalosje. Rezulton që pavioni të jetë vizituar nga 30.000 persona.

Seminar “Mbi implementimin e Rregullave të Detyrueshme të Korporatave në hapësirën frankofone”

Zyra e Komisionerit organizoi seminar me përfaqësues të sektorit bankar, telekomunikacionit dhe autoriteteve publike të cilët transferojnë të dhëna në vendet frankofone. E ftuar në këtë organizim ishte ekspertja franceze, përgjegjëse e sektorit të transferimit ndërkombëtar në Autoritetin Francez e cila prezantoi për të pranishmit standardet thjeshtuese mbi zbatimin e rregullave të detyrueshme të korporatave për transferimin ndërkombëtar si dhe prezantoi raste praktike të zbatimit të tij.

IV. AKTIVITETI LIGJOR

IV.1 Miratimi i akteve nënligjore

Zhvillimet e rëndësishme të ndodhura në kuadër të pasurimit të veprimtarisë ligjore u arritën nëpërmjet hartimit të akteve nënligjore, të udhëzuesve apo udhërrëfyesve shpjegues të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Gjatë këtij viti u miratuan 4 udhëzime nga Komisioneri dhe u botuan në Fletore Zyrtare.

1. ***Udhëzimi Nr.95, datë 07.04.2014 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”*** hartuar bashkërisht ndërmjet Komisionerit për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e Dhënave Personale dhe Ministrit të Punëve të Brendshme. Ky udhëzim përcakton institucionet të cilat kanë akses në regjistrin e gjendjes civile, bazën ligjore në këtë rast, qëllimin për të cilin përdorin të dhënat personale, sasinë dhe llojin e tyre.
2. ***Udhëzimi Nr. 40, datë 13.06.2014 “Mbi përdorimin e shërbimit të internetit dhe postës elektronike zyrtare në institucionet publike në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale”***. Qëllimi i këtij Udhëzimi është përcaktimi i rregullave të detyrueshme për zbatim nga institucionet publike dhe strukturat përkatëse të cilat administrojnë sistemet e

informacionit gjatë përdorimit të internetit dhe postës elektronike në vendin e punës nga ana e punonjësve.

3. ***Udhëzimi Nr. 41, datë 13.06.2014 “Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave”.*** Udhëzimi ka si qëllim përcaktimin e rregullave të detyrueshme për zbatim nga kontrolluesit publik ose privat në lidhje me rastet e transferimit ndërkombëtar në vende që nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.
4. ***Udhëzimi nr. 42, datë 22.07.2014 për “Përpunimin e të dhënave të kandidatëve për punë”.*** Udhëzimi ka për qëllim përcaktimin e rregullave për përpunimin e të dhënave personale gjatë periudhës së rekrutimit të punonjësve si në institucionet publike ashtu edhe në ato private.

Në kuadër të ilustrimit me shembuj konkret të Udhëzimeve të miratuara, me qëllim zbatimin lehtësisht të tyre, është përgatitur “Përmbledhëse me raste praktike të zbatimit të udhëzimeve të miratuara nga Komisioneri” e cila është publikuar edhe në faqen e internetit të institucionit www.idp.al.

IV.2 Udhëzues/udhërrëfyes të miratuar

1. ***Udhëzues “Mbrojtja e të dhënave personale në Kodin Etik”.*** Në përmbushje të kërkesave të lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale për vitin 2013” për të nxitur kontrolluesit në hartimin e kodeve të etikës dhe vlerësimin e tyre, në respektim të nenit 31/gj të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, është miratuar ky dokument i cili përmban disa parime kryesore lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale. Çdo kontrollues do të duhet të mbajë në konsideratë përfshirjen e tyre në kodet e etikës.
2. ***“Udhërrëfyes për Autoritetet Publike mbi projekt/aktet që kanë të bëjnë me të dhënat personale, në kuadër të nenit 31/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008”.*** Ky dokument do të nxisë kontrolluesit që kanë nismën ligjore për të dërguar projekt/akte ligjore e nënligjore për mendim pranë Komisionerit përpara dërgimit të tyre në KM për miratim. Udhërrëfyesi është publikuar në faqen online të KMDP-së dhe njëkohësisht i është dërguar edhe të ngarkuarve të kontrolluesve, nëpërmjet kanalit të komunikimit.
3. ***“Udhëzues për mbrojtjen e të dhënave personale në shërbimet cloud computing”.*** Nisur nga zhvillimet e vrullshme të teknologjisë, ky dokument i nevojshëm specifikon parimet e përgjithshme, të aplikueshme për kontrolluesit dhe përpunuesit që përpunojnë të dhëna në shërbimet cloud, duke përfshirë rëndësinë e përcaktimit të qëllimit, fshirjen e të dhënave dhe masat teknike dhe organizative. Udhëzuesi është publikuar në faqen online të KDIMDP-së dhe i adresohet kontrolluesve përmes kanalit të komunikimit dhe synon të prezantohet në trajnime të ardhshme me këtë kategori kontrolluesish.

4. **“Udhëzues mbi Transferimin Ndërkombëtar të të Dhënave Personale”**. Si standard bashkëkohor është hartuar për t’i ardhur në ndihmë kontrolluesve dhe subjekteve të të dhënave mbi qartësimin e koncepteve dhe procedurave që duhet të aplikohen në çdo rast në lidhje me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale. Udhëzuesi është publikuar në faqen online të KDIMDP-së dhe i është dërguar personave të ngarkuar në kontrollues të ndryshëm.
5. Është miratuar Rregullorja e KDIMDP-së për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, në përputhje me rregulloren tip të propozuar nga ILDKPKI dhe të publikuar në “Manualin shpjegues dhe trajnimi mbi rolin e autoriteteve përgjegjëse në parandalimin e kontrollin e konfliktit të interesave”.
6. Në kuadër të përafrimit me standardet ndërkombëtare është përgatitur materiali mbi termin **“Pëlqimi”**, bazuar në Opinionin e Grupit të punës të nenit 29 të Direktivës 95/46 të KE. Interpretimet në të, ndihmojnë zbatuesit e ligjit në lidhje me kuptimin dhe përdorimin e saktë të këtij termi, duke pasqyruar aspekte për mënyrën se si ai duhet zbatuar dhe vënë në praktikë rast pas rasti.
7. Si mjet ndërgjegjësues i përdorur në takime, trajnime e kontakte të herë pas hershme janë vlerësuar edhe përgatitjet e fletëpalosjeve. Fletëpalosja *“Transparenca në administratën publike dhe mbrojtja e të dhënave personale”*, rekomandon institucionet shtetërore të zhvillojnë politika të brendshme për kërkesat për akses në dokumente zyrtare. Ndërsa, fletëpalosja *“Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”*, botimi i së cilës u mbështet nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, shpjegon disa nga të drejtat dhe detyrimet e ligjit të ri për të drejtën e informimit.

IV.3 Dhënie mendimi për projekt/akte ligjore dhe nënligjore

Në zbatim të përgjegjësiave që ligji për mbrojtjen e të dhënave personale parashikon për dhënien e mendimeve për projekt/akte ligjore, është dhënë mendim për **10 projektligje**, projektligjin *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”*; projektligji *“Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”*; projektligjin *“Për sigurimin e depozitave”*; projektligjin për *“Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme”*; projektligjin *“Për armët”*; projektligji *“Për sigurinë fizike private; . propozime për ndryshime në ligjin Nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”*; propozime për ndryshime në ligjin Nr. 8951, datë 10.10.2002 *“Për numrin personal të shtetasve”*; Projektligjin *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*; Projektligjin *“Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”*.

Është dhënë mendim për **19 projekt/akte nënligjore**, për projekt/vendimin e Këshillit të Ministrave “Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar, nga siguri i detyrueshëm shëndetësor”; “Projekt marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë”; projektvendimin e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e formatit dhe mënyrës së mbledhjes dhe raportimit të të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, publik ose privat”; “Konventën e Këshillit të Evropës mbi falsifikimin e produkteve mjekësore dhe krimeve të ngjashme që paraqesin kërcënim”, projektvendimin për “Miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Sllovaqe mbi bashkëpunimin për të luftuar terrorizmin, krimin e organizuar, trafikun e paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve të drogës dhe krimeve të tjera”, etj.

Krahasuar me vitin e kaluar vërehet rritje e numrit të projekt/ligjeve dhe projekt/akteve nënligjore të ardhura për mendim pranë Zyrës së Komisionerit. Nga verifikimi në fletoret zyrtare konstatohet se, jo të gjitha aktet normative që trajtojnë të dhënat personale dërgohen për mendim pranë Zyrës së Komisionerit. Do të ishte në dobi të punës së të gjithë institucioneve propozuese të akteve normative konsultimi përpara miratimit të aktit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit është duke identifikuar të gjitha aktet dhe rezolutat ndërkombëtare për të bërë të mundur zbatimin e tyre në Shqipëri, përmes ratifikimit të konventave ose transpozimit nëpërmjet akteve nënligjore.

IV.4 Përmbushja e detyrimeve ligjore

Subjekteve të ligjit i është dhënë prioritet në lidhje me kërkesat e ardhura për opinione ligjore apo asistencë juridike mbi zbatimin e ligjeve respektive, të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Ndër tematikat më të kërkuara për informacion kanë qenë kryesisht kërkesa për interpretime lidhur me përkufizimet e akteve normative, lejimin e përpunimit të të dhënave personale, ushtrimin e të drejtës së aksesit por edhe lidhur me procedurat që duhen ndjekur gjatë shkëmbimit të të dhënave personale ndërmjet kontrolluesve apo ndërmjet strukturave të ndryshme brenda një kontrolluesi. Këto kërkesa janë drejtuar nga sektorë të ndryshëm, autoritete publike, kontrollues publik dhe privat.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe kërkesave për transferim ndërkombëtar të të dhënave personale. Janë shqyrtuar gjashtë praktika dhe janë dhënë 4 vendime, përveçse janë dhënë disa opinione për sistemin bankar në kuadër të transferimit të të dhënave personale të klientëve si kërkesë e zbatimit të ligjit FATKA. Procedurat e transferimit ndërkombëtar kanë shënuar ritme të reja në shqyrtimin e tyre në sajë edhe të miratimit të udhëzimit të ri por edhe të udhërrëfyesit i cili orienton dhe thjeshton mënyrën që duhet ndjekur nga çdo kontrollues në rastet

e paraqitjes së një kërkesë për transferim. Standardi i përdorur është bashkëkohor dhe i implementuar nga praktikat më të mira ndërkombëtare.

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit për vitin 2013, ka filluar bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë nëpërmjet grupit të punës për “Anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore të publikuara në portalet zyrtare të sistemit gjyqësor”.

Gjithashtu, gjatë këtij viti Komisioneri ka autorizuar Kontrolluesin **Ministria e Mbrojtjes** mbi kërkesën e saj **për të kryer “Përpunimin e të dhënave biometrike/shenjave të gishtërinjve, për një kategori të caktuar të stafit”** nëpërmjet vënies në përdorim të sistemit përkatës. Qëllimi kryesor i reflektuar në kërkesë ishte trajtimi në nivel të lartë i informacioneve të klasifikuara në funksion të sigurisë kombëtare.

IV.5 Raportime

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë këtij viti ka mbajtur kontakte të rregullta me ministrinë të cilat raportojnë për të përmbushur detyrimet e vendit në kuadër të integritetit evropian e më gjerë. KDIMDP ka raportuar në Ministrinë e Integritetit Evropian lidhur me takimin e VI të nënkomitetit për *Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë*, BE – Shqipëri, ka raportuar në Ministrinë e Drejtësisë lidhur me hartimin e kontributit të Qeverisë Shqiptare për Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, si dhe ka raportuar lidhur me hartimin e Kontributit të dytë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Raportin e Progresit 2014 të Komisionit Evropian për Shqipërinë për Kapitullin “Kriteri Politik” dhe Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”.

Në kuadër të ardhjes së Misionit të Ekspertëve (Misioni i Vlerësimit të Komisionit Evropian) “Peer Mission Review”, është raportuar mbi çdo informacion apo çështje të kërkuar. Qëllimi i takimeve ishte verifikimi në terren dhe vlerësimi i zbatimit të reformave kryesore në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian të institucioneve të pavarura. Janë evidentuar 36 rekomandime të adresuara zyrës së Komisionerit, të cilat do të duhen të konsiderohen dhe implementohen sipas institucioneve përkatëse.

Komisioneri në muajin tetor ka raportuar në Kuvendin e Shqipërisë lidhur me vlerësimet e bëra në Progres Raportin e BE-së për vitin 2014 për Shqipërinë si dhe mbi nismat e ndërmarra për rekomandimet e lëna.

Është raportuar në muajin nëntor në kuadër të hartimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet 2014-2020, në seksionin “**Të Drejtat e Njeriut**”. Nën misionin tonë institucional, kemi identifikuar objektivat që synojmë të arrijmë dhe kostot financiare të kërkuara për realizim.

V. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL

V.1 Marrëveshje Bashkëpunimi

Gjatë këtij viti janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi midis Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe:

1. Universitetit New York Tirana;
2. Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike;
3. Shërbimit Kombëtar të Punës;
4. Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë;
5. Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.

Janë zhvilluar takime dypalëshe të cilat kanë sjellë kontribut real në përmirësimin e praktikave bashkëpunuese midis KDIMDP-së dhe Autoriteteve të tjera Publike. Është në proces nënshkrimi i të tjera marrëveshjeve të bashkëpunimit me interes reciprok në organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta.

Pjesëmarrje e Zyrës së Komisionerit në takim me Prokurorinë e Përgjithshme

Në muajin tetor, KDIMDP mori pjesë në takim me Prokurorinë e Përgjithshme mbi përmbushjen e detyrave të lëna nga “Udhëzuesi për 5 Prioritetet e Komisionit Evropian” të adresuara për Prokurorinë, në kuadër të dhënies së aksesit në bazat e të dhënave të regjistrave publikë, si një element i lidhur drejtpërsëdrejti me efektivitetin e ushtrimit të ndjekjes penale. Ky takim u organizua me kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit midis institucioneve. Në takimin midis dy Autoriteteve të Pavarura u ra dakord për të mbikëqyrur në vijimësi punën e institucioneve që do të lejojnë aksesin për organin e Prokurorisë për sa i përket dokumentimit, masave të sigurisë, kryerjes së njoftimit përpara përpunimit të të dhënave, etj.

Komisioneri takon Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive

Komisioneri zhvilloi një takim, të koordinuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, me Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive. Synimi parësor në këtë takim ishte prezantimi i nevojës për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në hartimin e projekt akteve, detyrim që buron nga shkronja a) e nenit 31, të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Në këtë organizim u prezantua edhe Udhërrëfyesi ‘Për autoritetet publike mbi projekt aktet që kanë të bëjnë me të dhënat personale’.

Takim për koordinimin e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit dhe Inspektoratit të Përgjithshëm të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

Në muajin tetor Komisioneri dhe Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave zhvilluan një takim pune për të diskutuar mbi koordinimin dhe bashkëpunimin nëpërmjet dy institucioneve në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore përmes shkëmbimit të eksperiencave, ku ndërmjet të tjerave është konkluduar për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi.

V.2 Marrëdhënie Ndërkombëtare

Pranimi i organizimit të CEEDPA në Shqipëri

Në muajin Prill, në Shkup të Maqedonisë, u zhvillua Takimi i 16-të i Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEDPA). Konferenca synonte shkëmbim eksperiencash, diskutime, opinione e mendime për përmirësime të tjera në fushën e të dhënave personale duke synuar kryesisht unifikim të praktikave të punës. Në konferencë u diskutuan kërkesat e motivuara të Bosnje Hercegovinës, Hungarisë dhe vendit tonë për të qenë njëri prej tyre pritësi i takimit të ardhshëm. Pjesëmarrësit vlerësuan dhe pranuan kërkesën e Autoritetit Shqiptar si organizatori i ardhshëm i këtij aktiviteti të rëndësishëm, i cili do të zhvillohet në datat 29-30 Prill 2015.

Bashkëpunime me TAIEX

Stafi i Komisionerit ka vazhduar trajnimin e tij në disa Autoritete homologe falë mbështetjes së Instrumentit TaieX. Këto trajnime kanë qenë në kuadër të rritjes së profesionalizmit, kryesisht për sa i përket legjislacionit në regjistrat publik, njoftimit të shkeljes së privatësisë si dhe rolit e punës së oficerëve të mbrojtjes së të dhënave.

Antarsimi në GPEN

Në muajin mars u anëtarësuaam në rrjetin botëror të bashkëpunimit të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (Global Privacy Enforcement Network, GPEN). Në këtë rrjet autoritetet kanë mundësinë të shkëmbejnë eksperiencat të ndryshme për çështje dhe problematika të zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Grupi i punës ndërkombëtar “Për edukimin digjital”

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është pjesë e grupit ndërkombëtar të punës “Mbi edukimin digjital”. KDIMDP është anëtare e këtij

grupi duke kontribuar, ndër të tjera, edhe në hartimin e një dokumenti mbi metodologjinë e ndërgjegjësimit të fëmijëve mbi të drejtën e mbrojtjes së privatësisë.

Konferenca rajonale “Liria e informimit publik – zhvillimi i praktikave në rajonin e ballkanit perëndimor”

Në datën 18 shtator, u përfaqësua në Konferencën Rajonale “Liria e informimit publik – Zhvillimi i praktikave në rajonin e Ballkanit Perëndimor” të organizuar nga Zyra për Komunikim Publik e Qeverisë së Kosovës në bashkëpunim me zyrën e Misionit të OSBE-së në Kosovë. Në këtë konferencë u prezantua puna institucionale si dhe praktikat më të mira të mbrojtjes së të dhënave personale në Shqipëri.

Konferenca e 36 –të e Komisionerëve për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Privatësinë

Në datat 13-16 tetor, u zhvillua Konferenca e 36-të e Komisionerëve për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Privatësinë. Zyra e Komisionerit, mori pjesë në sesionin e mbyllur të Konferencës, të rezervuar vetëm për anëtarët e saj si edhe në sesionin e hapur dy ditor, i rezervuar për kontrolluesit dhe publikun e gjerë. Gjatë sesionit të mbyllur u diskutuan dhe u miratuan këto dokumente:

- Deklarata e Morisit në lidhje me “Internet of Things”;
- Rezoluta mbi akreditimin për anëtarësim të Autoriteteve të Landit të Bremenit, Ganës dhe Senegalit, dhe me statusin e vëzhguesit: Bermudan, Japoninë, Shtetin e Meksikos, Singaporin dhe Komisionin e Tregtisë së Ardhshme të Shteteve të Bashkuara;
- Rezoluta mbi Big Data-t;
- Rezoluta mbi Implementimin e Bashkëpunimit;
- Rezoluta në lidhje me Privatësinë në erën digjitale.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr pjesë në Forumin Evropian të Qeverisjes së të Dhënave

Në muajin dhjetor u zhvillua në Paris, në selinë e UNESCO-s, Forumi Evropian i Qeverisjes së të Dhënave “Privatësia, inovacion dhe mbikëqyrje: Çfarë kuadri etik duhet për Evropën?”. Ky Forum u organizua nga Autoriteti francez CNIL me pjesëmarrjen e Kryeministrit të Francës dhe bashkonte 28 Autoritete evropiane (vendet anëtare të BE), anëtare të Grupit të Punës së Nenit 29 ndërkohë që një ftesë e posaçme iu bë edhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Shqipërisë.

Nga Grupi i Punës së Nenit 29 u miratua "Deklarata e Përbashkët e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave të GP29". Kjo Deklaratë është e një rëndësie të veçantë në planin ndërkombëtar, pasi i bën jehonë vlerave evropiane në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë, rritjes së besimit të publikut mbi shërbimet e ekonomisë digjitale, edukimin digjital, transparencës së përpunimit të të dhënave, qarkullimin ndërkufitar të të dhënave, etj.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka marrë pjesë në disa evente të rëndësishme ndërkombëtare

- Workshop shumë-planësh mbi auditimin e mbrojtjes së të dhënave me vëmendje të veçantë në vulat e mbrojtjes së të dhënave sikurse European Privacy Seal (EuroPriSe);
- Takimi i 31-të Plenar i Komitetit Konsultativ të Konventës për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale (T-PD)”;
- Konferenca Evropiane e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave;
- Trajnim i Korrespondentëve të BCR-ve (*Binding Corporate Rules*) frankofone;
- Inspektim i Ambasadës shqiptare në Mbretërinë e Bashkuar (UK) si dhe vizitë studimore pranë Autoritetit të Zyrës së Komisionerit të Informimit të Mbretërisë së Bashkuar ICO;
- Workshopi i 26-të i Trajtimit të Rasteve;
- “Sigurimi i mbrojtjes së të dhënave personale ndërkohë që sigurohet hapësira kibernetike – Sfidat dhe perspektivat për vendet e Evropës juglindore”;
- Konferenca e Pestë e Përvitshme Ndërkombëtare “Puna e Autoriteteve Kombëtare dhe Ndërkombëtare në Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;
- Workshopi “Mbrojtja e të Dhënave në Parandalimin dhe Hetimin e Mashtrimit Financiar (të Korporatave)”;
- Konferenca Rajonale e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave të Ballkanit Perëndimor;
- “Zbatimi i privatësisë: mësimet e nxjerra nga implementimet aktuale dhe perspektivat e të ardhmes”;
- Takimi dypalësh midis përfaqësuesit të KDIMDP-së dhe Sekretariatit të GIODO-s, në Krakov të Polonisë me fokus organizimin e konferencës së CEEDPA në Shqipëri.

VI. BURIMET NJERËZORE DHE MENAXHIMI FINANCIAR

VI.1 Struktura Organizative

Burimet njerëzore janë një nga asetet më të rëndësishme, përshtatja e zhvillimi i tyre me ndryshimet e legjisllacionit të ri, jep mundësinë e ofrimit dhe promovimit për nivelin e shërbimit profesional. Përmirësimet në strukturë, kanë qenë në fokusin e politikave të burimeve njerëzore me qëllim rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së punës së institucionit, duke forcuar bashkërendimin dhe koordinimin e punëve midis strukturave, përshtatjen e tyre me detyrat e reja që burojnë nga objektivat strategjike të institucionit si dhe arritjen e standardeve evropiane.

Miratimi i ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, parashikoi kompetenca të reja për Zyrën e Komisionerit në fushën e të drejtës së informimit, përveçse ndryshoi dhe emërtesën e tij në Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kuvendi miratoi me Vendimin nr.106/2014, datë 18.12.2014 “Strukturën, organikën dhe klasifikimin e pagave të Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, e cila do të përmbushë çdo kompetencë dhe detyrim ligjor. Funksionimi dhe pritshmëritë e saj do të japin rezultate në vitin 2015, sa i përket sfidave të mëtejshme të zyrës, ndërgjegjësimit në të gjithë kategoritë e përfaqësuara, deri në krijimin e një kulture gjithëpërfshirëse në informim dhe në mbrojtjen e të dhënave.

VI.2 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Nëpërmjet strukturës përkatëse janë mbikëqyrur dhe menaxhuar burimet njerëzore, duke zbatuar ndryshimet në legjislacionin për shërbimin civil, në respektim të parimeve kryesore të tij, për të mundësuar reduktimin e subjektivizmit në procesin e konkurrimit, përzgjedhjes së kandidatëve të kualifikuar profesionalisht, bazuar në merita, transparencë dhe llogaridhënie.

Duke vlerësuar kapitalin njerëzor dhe aftësitë profesionale të stafit në realizimin me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe objektivave strategjike, kemi vlerësuar përfitimin e njohurive, shkëmbimin e eksperiencave ndërkombëtare, për unifikimin apo përafrimin e legjislacionit, duke aplikuar dhe përfituar vizita studimore me fonde tërësisht të TAIEX-it.

Gjithashtu janë programuar dhe zhvilluar kapacitetet profesionale, edhe me burimet e brendshme, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA). Përfitimi i trajnimeve për një pjesë të stafit si dhe për stafin e rekrutuar rishtazi (në kohë prove), është arritur në fushën e administratës publike, në ndryshimet e legjislacionit të shërbimit civil, të prokurimeve, etj.

Një nga prioritetet dhe kriteret e integritetit evropian, për reformën në administratën publike drejt një qeverisje të mirë e demokratike, është ekzekutimi në mënyrë të plotë i vendimeve gjyqësore, lidhur me nëpunësit civil të larguar.

Zyra e Komisionerit ka zbatuar plotësisht detyrimet që rrjedhin nga dy vendime gjyqësore të formës së prerë, rikthim në vendin e punës si dhe shlyerjen e plotë të detyrimeve financiare.

VI.2 Menaxhimi Financiar

Një drejtim tjetër jo më pak i vlerësuar në administrimin e brendshëm është mbulimi i veprimtarisë financiare të Zyrës së Komisionerit dhe mbajtja e përgjegjësisë së plotë për të gjitha procedurat e hartimit dhe të administrimit të fondeve të buxhetit, nëpërmjet përdorimit me efektivitet dhe efikasitet të fondeve të saj duke respektuar parimet dhe rregullat e menaxhimit financiar, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e buxhetit të Shtetit.

Zyra e Komisionerit, në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligjet organike mbi të cilat ushtron veprimtarinë e tij.

Sa i përket procesit të sigurimit të buxhetit administrativ të KDIMDP-së, është përpiluar dhe paraqitur dokumenti i kërkesave të *Programit Buxhetor Afatmesëm*, lidhur ngushtë me objektivat institucionale, duke vlerësuar maksimalisht kontributin e të gjithë aktorëve në procesin e miratimit të buxhetit të vitit 2015, e veçanërisht të Kuvendit, për mbështetjen logjistike, burime njerëzore e financiare, buxhet i cili kap shifrat më të larta, që nga krijimi dhe funksionimi i veprimtarisë së tij, me një rritje prej rreth 50 %. Në mbështetje të ligjit nr.185, datë 28.12.2013 “Për Buxhetin e vitit 2014”, është miratuar për Zyrën e Komisionerit programi buxhetor “Planifikim, menaxhim, administrim”.

Buxheti i miratuar, në nivel programi për vitin 2014 është realizuar në masën **89 %**. Informacioni i detajuar jepet në pasqyrën e paraqitur më poshtë. Mosrealizimi në masën 11 % ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore si pasojë e krijimit të vendeve vakante, ndryshimit të legjislacionit ligjor dhe nënligjor të nëpunësit civil, procedurave të pasukseshme të rekrutimit të kategorisë së mesme drejtuese, me procedurën e lëvizjes horizontale-paralele, procedurë e vështirë për t’u realizuar nga institucionet e pavarura, si dhe pritjes së ndryshimit të strukturës, zbatimi i së cilës është në proces.

Treguesit e performancës së shpenzimeve të tjera buxhetore përfshirë edhe investimet, këtë vit paraqiten në nivele të larta, me realizim në masën 99 %, referuar tabelës.

Tabela e akordimit të buxhetit dhe realizimi për vitin 2014

Transferimet, ndryshimet e realizimet në mijë/ lekë

Nr	Emërtimi	Plan	Struktura Kundrejt Planit Në %	Fakt	Realizimi Kundrejt Planit Në % .
1	Paga	28.640	61	24.410	85 .
2	Sigurime shoqërore	4.609	9.8	3.913	84
3	Mallra e shërbime të tjera	12.231	26	12.214	99.8
4	Investime	1.000	2	998	99.8
5	Transferta të buxhetit familjar	500	1	320	64
6	Kuotizacion	100	0.2	86	86
	Totali	47.080	100	41.941	89

Të ardhurat e institucionit

Për vitin 2014, të ardhurat nga veprimtaria e KDIMDP-së janë kryesisht nga:

1. Gjobat e kamatat e vendosura në rastet e shkeljeve të zbatimit të detyrimeve ligjore, nga kontrolluesit, në shumën 949.000 lekë, që derdhen 100 % në buxhetin e shtetit.
2. Të ardhura të tjera të krijuara, sponsorizim nga organizatorë të eventeve ndërkombëtare, në shumën 491.000. lekë, pjesa e papërdorur e të cilave janë të trashëguara për vitin 2015, në shumën 73.000 lekë.

VII. PRIORITETET PËR VITIN 2015

Objektivi themelor për zhvillimin institucional të KDIMDP-së mbetet përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të zbatimit rigoroz të ligjit për të drejtën e informimit dhe ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë kuadër prioritetet për vitin 2015 janë:

- ✓ Rritja (krijimi) dhe forcimi i kapaciteteve administrative për të mbikëqyrur, monitoruar, koordinuar, hetuar deri në vendosjen e sanksioneve administrative.
- ✓ Forcimi i kapaciteteve institucionale nëpërmjet investimeve për zhvillimin e infrastrukturës informatike dhe për krijimin e një ndërveprimi me të gjithë institucionet publike.
- ✓ Përfitim i projekteve IPA, me synim përafrimin dhe implementimin e standardeve më të mira në tematika të caktuara në të dy ligjet përkatëse.
- ✓ Përmirësim i kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare.
- ✓ Ngritja dhe krijimi i Regjistrit kombëtar online për koordinatorët e caktuar nga autoritete publike.

Gjithashtu, bashkëpunimi dhe përmirësimi i marrëdhënieve ndër-institucionale duke synuar krijimin e një kulture gjithëpërfshirëse për informim dhe në të njëjtën kohë për mbrojtjen e privatësisë.

Do të ndërmerren iniciativa bashkëpunuese me kontrolluesin Media, si aktor i rëndësishëm në publikimet e lajmeve, në respektim të mbrojtjes së të dhënave personale kryesisht për fëmijët e abuzuar seksualisht.


- ✓ Synohet nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Autoritetin e Mediave Audiovizive me qëllim monitorimin e etikës në media, ndërjegjësimin e tyre në njohjen dhe zbatimin e ligjeve respektive.

Vlerësohet ndërmarrja e iniciativës për hartimin e një projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të pavarura” me qëllim krijimin e një sistemi të unifikuar duke

respektuar autonominë, pavarësinë e strukturës organizative dhe buxhetit të institucioneve të pavarura në përputhje me gjetjet dhe rekomandimet e Misionit të Ekspertëve të Vlerësimit të Komisionit Evropian “Peer Mission Review”.

VIII. STATISTIKA DHE GRAFIKË

E drejta e informimit




Janë dhënë **2 vendime** për urdhërim dhënie dokumentacioni.

Mbrojtja e të dhënave personale

Formularë Njoftimi


- Kontrollues Publik
- Kontrollues Privat
- OJF



Totali i formularëve të njoftimeve të deklaruar **4707**

Formularë të Regjistruar

- Kontrollues Publik
- Kontrollues Privat
- OJF




Totali i formularëve të njoftimeve të regjistruara **4665**


Sanksione administrative dhe ekzekutimi i detyrueshëm në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale



Periudha 2010-2013	Viti 2014
57 vendime me sanksion administrativ me gjobë	22 vendime të paekzekutuara / të mbartura
30 vendime të ekzekutuara nga zyrat e përmbartimit	16 vendime të ekzekutuara
2 vendime të revokuara	6 vendime në proces ekzekutimi
3 vendime të ankimuara	




*Për vitin 2014 janë paraqitur **73 ankesa** lidhur me përpunimin e të dhënave personale, **36 prej tyre** janë trajtuar administrativisht.*



Hetimi Administrativ për vitin 2014		
Kontrolle	Inspektive	Verifikime
67 Kontrolle të administrative me objekt të përgjithshëm. Kontrolle sektoriale - shoqëritë e sigurimit - autoritete publike	37 inspektive <u>në terren</u> - 27 me objekt verifikim i zbatimit të rekomandimeve/ urdhrit të Komisionerit. - 10 me objekt tjetër.	53 verifikime <u>online</u> rekomandimesh/ urdhri
	53 inspektive <u>online</u>	27 verifikime rekomandimesh/urdhri në terren.
	90 inspektive administrative	
	Në total 157 kontrolle/inspektive administrative	
		Në total 80 verifikime

11 vendime (19 sanksione gjobë)	Dhënë gjatë vitit 2014
5 vendime	Ekzekutuar vullnetarisht
2 vendime	Ankimuar në gjykatë
4 vendime	Në proces ekzekutimi

Aktiviteti Ligjor



**KUADRI LIGJOR
PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

